



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Opština Klokot/Komuna e Klllokot

Datë: 28.02.2020

Në bazë të nenit 12 pika 12.2.paragrafi(d) neni 17.paragrafi (b) neni 40.(1) Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040,neni 5,pika 1.2. paragrafi 1.2.2.neni 10 pika 2.paragrafi 2.1. neni 11.neni 16 neni 26 Ligjit nr. 04L-174 mbi planifikimin hapësinor,si dhe Statutit të komunës neni 8. Pika 8.1. paragrafi (b) neni 13. (1) Kuvendi i Komunës së Klllokotit në seancën e dytë të rregullt merr :

V E N D I M

Mbi hartimin e hartës zonale në teritorin e komunës së Klllokotit

Neni 1.

Në seancën e dytë të rregullt të Kuvendit të komunës së Klllokotit e mbajtur me datë 28.02.2020 në hapësirat e „Shtëpisë së Kulturës” në Klllokot, **u miratua vendimi mbi hartimin a hartave zonale në teritorin e komunës së Klllokotit.**

Neni 2.

Në bazë të propozim vendimit nr. 183/5 të datës 18.02.2020 e sjellur nga ana e drejtorisë për kadastër,urbanizëm dhe gjeodezi,Kuvendi ka miratuar vendimin në titull me votim publik: PËR votuan 11 delegatë,Kundër nuk kishte,3 delegatë nuk u deklaruan,1 nuk mori pjesë në votim.

Neni 3.

Ky vendim nga neni 1.do të mundësoj hartimin strategjik të dokumentit të definuar si Plan Hapësinor komunal, Harta hapësinore komunale në përputhje me ligjin përcaktohet si një dokument multi-sektorial që përshkruan llojin, tabela, fotografi, harta dhe tekste, destinacionin, përdorimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimt bazuar në kohëzgjatjen dhe parashikimet e investimeve legale publike dhe private për të gjithë komunën prej tetë (8) vjetësh.

Neni 4.

Kuvendi Komunal aprovon gjetjen e zgjidhjeve për financimin nga buxheti i komunës, fondet e donatorëve dhe gjetjen e burimeve njerëzore për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, Hartën e Komunës si një Plan Rregullues të detajuar me zbatimin e procedurës ligjore para miratimit në Kuvend.

Neni 5.

Për implementimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i komunës dhe drejtoria për kadastër,urbanizëm dhe gjeodezi.

Neni 6.

Ky vendim nga neni 1.hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga ana e kryesuesit të Kuvendit komunal Klllokot. Vendimi do të publikohet në web-faqen e komunës .

Kopja :

- MAPL;
- Kabinetit kryetarit komunës ;
- Drejtorisë për ekonomi,buxhet dhefinanca;
- Kryesuesit të K.K.Klllokot
- Arkivës së Komunës

Kryesuesi i
Kuvendit komunal Klllokot

/ Zarko Dejanović /